



05 Korrik 2024

Nr. 15 Prot

Drejtuar: Z. Fatmir Xhafaj  
Kryetar  
Komisioni i Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin, për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”.

I nderuar z. Xhafaj,

Dhoma Amerikane e Tregtisë (AmCham) dëshiron të shprehë vlerësimin e saj për çdo nismë që synon stabilitetin, mirëqeverisjen dhe luftën kundër korrupsionit. Ne e vlerësojmë shumë ftesën tuaj për të marrë pjesë në këtë proces të rëndësishëm. Në këtë drejtim, ne do të donim të shprehnim interesin tonë për të kuptuar më shumë rreth disa aspekteve organizative dhe përbajtësore të këtij Komisioni:

1. **Anëtarësia dhe Pjesëmarrja:** A mund të na jepni informacion në lidhje me anëtarësinë dhe përbërjen e këtij komisionit? Kjo do të na ndihmonte të kuptonim më mirë ekspertizën brenda komisionit.
2. **Temat e Diskutimit:** A mund të na jepni informacion pak më të detajuar rreth temave dhe çështjeve specifike që do të trajtojë komisioni, për të kuptuar më mirë ndikimin e pritshëm në anëtarësinë tonë dhe në përgjithësi në zhvillimin e biznesit.
3. **Angazhimi i Pritshëm i AmCham:** Cili do të jetë niveli dhe fusha e ekspertizës që kërkohet nga AmCham? Kjo do të na ndihmojë të vlerësojmë ekspertizën që ne duhet të angazhojmë në këtë proces.
4. **Palët e Përfshira:** Cilat janë palët e tjera të përfshira në këtë proces? (Palët e interesit ose organizata të tjera).

Gjithashtu, ne sugjerojmë organizimin e një takimi midis përfaqësuesve të AmCham (Drejtorit Ekzekutiv dhe Presidentit të Bordit të AmCham) dhe Kryetarit të Komisionit së bashku me përfaqësues të tjerë të komisionit. Ky takim do të shërbejë si një mundësi për të diskutuar më në detaje qëllimet dhe objektivat e këtij Komisioni, përfshirjen potenciale të AmCham, dhe rezultatet e pritshme.

Ne jemi të angazhuar të kontribuojmë me ekspertizën tonë dhe të bashkëpunojmë me komisionin për të ndihmuar që kjo iniciativë të jetë e suksesshme.

Ju falenderojmë për vëmendjen dhe bashkëpunimin tuaj.

Me respekt,

Neritan Mullaj  
Drejtor Ekzekutiv

